



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr. 1054/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Gyltene Sylejmani dhe Adnan Konushevci anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Fitore Isufi, duke vendosur përkitazi me apelin e Sali Vila, anëtarë për Kuvendin Komunal në Hani i Elezit, nga radhët e subjektit politik LDK, me seli në Prishtinë, dega në Hani i Elezit, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017 për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur më datë 13.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si i pabazuar apeli i parashtruar nga Sali Vila, anëtarë për Kuvendin Komunal në Hani i Elezit, nga radhët e subjektit politik LDK, me seli në Prishtinë, dega në Hani i Elezit, me shenjën ZL.Anr.1054/2017, të datës 13.11.2017, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017 pas shpalljes së rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar me postë apelin ZL.Anr.1054/2017 me datën 13.11.2017, nga Sali Vila, anëtarë për Kuvendin Komunal në Hani i Elezit, nga radhët e subjektit politik LDK, në të cilën pretendon se i mungojnë vota në vendvotimin në fshatin Gorancë dhe në fshatin Paldenic në vendvotimin nr.2 pretendon se i ka 15 vota.

PZAP-i, pas shqyrtimit të besueshmërisë dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore si dhe shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i pabazuar

Paneli pas vlerësimit të pretendimeve ankimore gjeti se parashtruesi në apel me asnjë provë bindëse nuk ka dëshmuar pretendimet e tij. Prandaj, Paneli apelin e konsideron si të

përgjithësuar dhe të pa argumentuar me fakte dhe si të tillë jo bindëse pasi që nuk i plotësoj kërkesat ligjore të përcaktuara me dispozitën e nenit 117 i Ligjit nr. 03/-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

Rrjedhimisht PZAP-i në mungesë të provave dhe dëshmive konkrete dhe bindëse për pretendimet e paraqitura në apel, konstaton se apeli në fjalë është i pabazuar dhe i pa argumentuar dhe si të tillë e refuzoj.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

ZL.Anr.1054/2017 më datën 13.11.2017.

Kryesuese e Panelit
Zyheir Haxhi



Udhëzim Juridike:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*